



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 441 Prot.

Tiranë, më datë 28.12.2022

**VENDIM**

**Nr. 563, datë 28.12.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknikë dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.12.2022:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik, në kuadër të projektit “Porti i ri i integruar i Durrësit, në Porto Romano”, me aplikues shoqëria “Abkons” sh.p.k. dhe zhvillues Autoriteti Portual Durrës;
2. Të realizohen sondazhet arkeologjike për traktet nr. 35-36, duke lidhur akt-marrëveshje 3-palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji si dhe IKTK e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore, në zbatim të Ligjit 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Eugen KALLFANI**

